# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-463451**
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Familjet Thaçi, Veseli e Krasniqi i përgjigjen Haxhiut pas ftesës për takim |
| ADRESA | `https://piranjat.al/kosova/familjet-thaci-veseli-e-krasniqi-i-pergjigjen-haxhiut-pas-fteses-per-taki-i105692` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 19:00:08 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 23 shtator 2026, 17:49:49 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `916d6126878fd04a0ace936cef62ad4c000f79791627248ad0fbb329270b4aea` |
| TEKSTI | `340c3a6ef6c910af32bc48a626dd6f216d04d3195b92aa4851387a1f90454692` |
| PAMJA | `ba0f7c0758fbc89ae3754885b49c9dc41fe11f38e2a0ead592d076ce5e59cbe9` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `23b35c74406fe3130252893c606b2af6535458cef9a86a9afd066052a06be621` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/23b35c74406fe3130252893c606b2af6535458cef9a86a9afd066052a06be621`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Flash: për akuzat | te problemi yt… Të gjithë | është bosi shqiptar i | dhe i konsideruar nga SPAK | strukturuar kriminal | drejtoreshën e S... | do të bjerë si tigër prej | k&e... | Ja kë po përpiqet të | Informativ të Shtetit, Vlora H...

KOSOVA

# Familjet Thaçi, Veseli e Krasniqi i përgjigjen Haxhiut pas ftesës për takim

Piranjat Përditësimi i fundit 23 Shtator 2026, 19:49




Familjet e Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe Jakup Krasniqit kanë publikuar një letër të përbashkët, përmes së cilës kanë bërë thirrje për përgjegjësi institucionale dhe unitet qytetar lidhur me zhvillimet pas procesit gjyqësor në Hagë.

Letra është bërë publike nga Altin Krasniqi, djali i Jakup Krasniqit, përmes një postimi në Facebook.

Në të, familjet kanë falënderuar qytetarët e Kosovës për mbështetjen dhe solidaritetin e treguar ndaj tyre dhe ndaj procesit në Hagë.

"Ne, familjet e Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe Jakup Krasniqit, bëjmë thirrje për përgjegjësi institucionale dhe unitet qytetar në këto momente", thuhet në letër.

Familjet theksojnë se presin nga të zgjedhurit e popullit një qasje të përgjegjshme shtetërore në raport me Dhomat e Specializuara.

"Presim sjellje të përgjegjshme shtetërore nga të zgjedhurit e popullit, në mbrojtje të Kushtetutës dhe ligjit, në raport me Dhomat e Specializuara", thuhet tutje.

Në letër është përmendur edhe ftesa e ushtruese së detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu, për takim me familjarët e ish-krerëve të UÇK-së. Ftesa për një takim gjatë kësaj jave ishte raportuar një ditë më herët.

Familjet Thaçi, Veseli dhe Krasniqi kanë bërë të ditur se e vlerësojnë ftesën, por kanë kërkuar që takimi të zhvillohet vetëm pas një vendimi të Kuvendit.

"E vlerësojmë ftesën e Albulena Haxhiut, por, për t'iu shmangur çdo keqkuptimi të mundshëm lidhur me ndikimin dhe ndërhyrjet familjare në vendimmarrjen e institucioneve të Republikës së Kosovës, presim që të takohemi pas vendimit të Kuvendit", thuhet në letër.

Një ditë më parë, mediat kishin raportuar se familjet e Thaçit dhe Veselit nuk pritej t'i përgjigjeshin pozitivisht ftesës së Haxhiut, ndërsa deri në atë moment nuk kishte pasur një qëndrim të përbashkët publik nga familjet.

Letra e publikuar nga Altin Krasniqi paraqet kështu një qëndrim të përbashkët të tri familjeve, të cilat kërkojnë që fillimisht institucionet e Kosovës të marrin vendimet përkatëse dhe më pas të zhvillohet takimi.

## Artikuj te sugjeruar

KOSOVA 23 Shtator15:33

**Kushtetuesja rrëzon opozitën, njeh Qeverinë e re të Kosovës. 6 tetori, afati i fundit për zgjedhjen e presidentit**

Gjykata Kushtetuese e Kosovës tha se Kuvendi i Kosovës është konstituuar përtej afatit 30-ditor, por megjithatë shtoi se deputet&e...

KOSOVA 23 Shtator09:02

**"Koha për të ecur përpara"/ Kallas takon Kurtin dhe Vuçiç: Marrëveshjet e dialogut, përfshirë atë të Ohrit, janë të detyrueshme**

Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Kaja Kallas, ka zhvilluar takime të ndara me kryemin...

KOSOVA 22 Shtator23:26

**Maqedonia e Veriut arreston ish-luftëtarin e UÇK-së**

Fadil Pushkolli, një ish-luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka njoftuar se është arrestuar nga autoritetet e Ma...

KOSOVA 22 Shtator22:29

**Nata e shtatë e protestës, mijëra qytetarë sërish në shesh kundër vendimit të Speciales**

Për të shtatën natë radhazi, mijëra qytetarë janë mbledhur në sheshin “Skënderbeu” në Prishtin&eum...

KOSOVA 22 Shtator21:37

**“Si u bë rrëfimi i Albin Kurtit baza e dënimit për Hashim Thaçin në Hagë?”, Lirim Mehmetaj: Dënuan krerët e UÇK-së për rastin e Behajdin Allaqit pa asnjë provë**

Gazetari Lirim Mehmetaj ka publikuar një analizë në Vox Kosova ku hedh dyshime të forta mbi mënyrën se si Gjykata Speciale në...

KOSOVA 22 Shtator21:07

**“Dera vazhdon të jetë e hapur”/ Djali i Jakup Krasniqit: Institucionet i presim prej gjashtë vitesh**

Altin Krasniqi, djali i Jakup Krasniqit, ka reaguar përmes një postimi publik, duke thënë se dera e shtëpisë së familjes s&eu...

KOSOVA 22 Shtator20:31

**Përshkallëzohen protestat në Kosovë, paralajmërohet tubim kombëtar më 1 tetor kundër dënimeve të ish-liderëve të UÇK**

Në kundërshtim të aktgjykimit të Gjykatës Speciale ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës t...

KOSOVA 22 Shtator20:29

**Kurti pas takimit me kryeministrin e Kroacisë: Aktgjykimi i Speciales është i pasaktë, i padrejtë dhe i rëndë**

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti përmes një postimi në “Facebook” ka ndarë detaje lidhur me takimin e tij të zhvill...

KOSOVA 22 Shtator19:13

**Endrit Thaçi ‘thyen’ rrjetin, emri i djalit të ish-liderit të UÇK-së, më i kërkuari në Google**

Ekspertja e IT, Nadia Elbasani ka treguar se ditën e vendimit të Hagës për ish-liderët e UÇK-së, emri i djalit të Ha...

KOSOVA 22 Shtator13:27

**“Zëri ynë të dëgjohet fuqishëm”, Diaspora në Gjermani e Finlandë në këmbë për Çlirimtarët**

Më 26 shtator, në Ulmë të Gjermanisë dhe në Kansalaistori të Helsinkit në Finlandë, do të organizohen protes...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 23 Shtator

**Skandal/ Kreu i SHISH mesazh Agasit: Zemër, duh...**

Më 18 shtator, Vlora Hyseni është marrë në pyetje nga agjentët e Byrosë Kombëtare të Hetimit si person në di...

POLITIKE 22 Shtator

**“Balluku kur do arrestohet?” - Gazetari Qyno: K...**

Gazetari Elton Qyno ka debatuar mbrëmjen e sotme me juristët në emisionin “Top Story”, lidhur me hetimet e SPAK ndaj ish-zëvend&...

AKTUALITET 22 Shtator

**“Pinte kafe çdo javë me Dumanin”/ Urdhër-arrest...**

Gazetari Elton Qyno ka komentuar mbrëmjen e sotme në ‘Top Story’ urdhër-arrestin e SPAK për kreun e SHISH, Vlora Hyseni. Qyno k...

Nga Xhuljan Ferzaj INVESTIGIME 23 Shtator11:40

**EKSKLUZIVE/ Eskortat e huaja “mbysin” Tiranën: Si vajzat nga Brazili, Kolumbia e Vietnami ofrojnë shërbime sek*uale për 50-150 euro**

Prostitucioni me shtetase të huaja po shfaqet gjithnjë e më hapur në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë. Përmes...

**video**



**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1**





**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1**




**“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit**




**Tmerri i 40-vjeçares / Si u shndërrua njohja e re në përndjekje, shantazh dhe denigrim në rrjet**





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.